



AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Drejtoria e Tregjeve dhe Masave Rregullatore

TREGUESIT STATISTIKORË TË SHËRBIMEVE POSTARE

Viti 2019



I. HYRJE

AKEP, me qëllim informimin e palëve të interesuara me treguesit kryesore të tregut postar, sipas raportimeve të bëra nga Ofruesi i Shërbimit Universal Postar “Posta Shqiptare” sh.a. dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare, ka përgatitur këtë raport në të cilin evidentohen treguesit kryesor të tregut postar për vitin 2019, i cili publikohet në faqen e Internetit të AKEP-www.akep.al, në seksionin “Statistika”.

Për shkak të ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave, jo të gjithë treguesit e raportuar nga Ofruesi i Shërbimit Universal Postar dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare publikohen nga AKEP.

Raporti ka natyrë periodike dhe përditësohet vazhdimisht me të dhënat statistikore të shërbimeve postare.

II. PANORAMË E PËRGJITHSHME

Në këtë raport statistikor janë paraqitur të dhënat periodike statistikore të shërbimeve postare për vitin 2019 të dërguara nga Ofruesi i Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare të pajisur nga AKEP me “Autorizim të Përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare”, në zbatim të kërkesave të Rregullores Nr.40, Datë 17.12.2015 “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike mbi shërbimet e ofruara nga ofruesit e shërbimeve postare”.

Subjektet e pajisur nga AKEP me “Autorizim të Përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare” të regjistruar në regjistrin e AKEP janë:

- **Ofruesi i Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare sh.a.**
- **Ofruesit e shërbimeve postare (18 subjekte):**

1. Albanian Cargo Service sh.p.k (A.C.S)
2. Albanian Courier sh.p.k (A.C)
3. Albanian Delivery Express sh.p.k (ADEx)
4. DHL International (Albania) sh.p.k
5. RAD MAIL sh.p.k
6. Sky Net Logistic sh.p.k
7. TNT Express Albania sh.p.k
8. Ulysses Enterprises sh.p.k (Fedex)
9. United Transport sh.p.k (Uni Trans)
10. Youth Albania Professional Services (YAPS)
11. Fast-Delivery sh.p.k
12. E-KOMPLET sh.p.k
13. COEX shpk
14. Albanian Parcel Distribution shpk
15. Speed Couriers Albania
16. Intex Courier sh.p.k
17. Turboo Albania sh.p.k
18. Panorama Group sha

AKEP, për subjektet e sipërcituar:

- Në mbështetje të nenit 64 pika 3 e ligjit 46/2015, me Vendimin Nr.2581, datë 22.06. 2015 ka pajisur Posta Shqiptare sh.a., me Autorizim Individual për ofrimin e shërbimit universal postar, me afat 5 vjeçar.
- Në zbatim të Ligjit Nr.46/2015 “Për Shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të Rregullores nr. 38, datë 19/11/2015, “Për Autorizimin e Përgjithshëm për Ofrimin e Shërbimeve Postare, subjektet e sipërcituar janë pajisur nga AKEP me Certifikatë të Konfirmimit të Njoftimit për ofrimin e shërbimeve postare që nuk bëjnë pjesë në shërbimin universal postar sipas Regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm.

III. PËRMBAJTJA E TË DHËNAVE

Të dhënat statistikore postare të dërguara përmbajnë kryesisht:

1. Treguesit dhe evidenca e realizimit të shërbimeve postare;
2. Treguesit e shërbimit universal postar;
3. Treguesit e shërbimeve ekspres/jo universale;
4. Treguesit teknik dhe të rrjetit;
5. Cilësia / Standardet e realizimit të shërbimeve postare;
6. Të punësuarit;
7. Ankesat e përdoruesve (Reklamacionet);
8. Të ardhurat financiare nga shërbimet postare

Posta Shqiptare, si ofrues i shërbimit universal postar ka plotësuar Formularin A me të dhënat statistikore postare respektivisht të përcaktuara nga pika A deri në pikën H, ndërsa ofruesit e tjerë të shërbimeve postare kanë plotësuar Formularin C me të dhënat statistikore postare respektivisht të përcaktuara nga A deri në pikën G.

IV. TRAJTIMI DHE PARAQITJA E TË DHËNAVE

Të dhënat e dërguara dhe të trajtuara në këtë raport jepen për zërat kryesorë të shërbimeve postare, në të cilat përfshihen nën-zërat e tyre.

Paraqitja e të dhënave është bërë në mënyrë tabelore dhe grafike duke ju referuar të dhënave për objektet postare të pranuar si dhe krahasimi me vitet e paraardhëse.

1. Të dhëna përmbledhëse të shërbimeve postare

Gjatë vitit 2019 rezultojnë 29,676,180 objekte postare të pranuar nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare:

Tabela 1.1- Të dhëna mbi kategoritë kryesore të objekteve postare (2018-2019)

Shërbime postare të ofruara		Objekte postare 2018	Objekte postare 2019	Ndryshim 2019/2018
Posta Shqiptare sh.a				
1	Shërbim Universal Postar			
1,1	Postë brenda vendit	18.298.143	19.617.824	7,2%
1,2	Postë ndërkombëtare	1.413.574	4.852.454	243,3%
1,3	Totali 1.1+1.2	19.711.717	24.470.278	24,1%
2	Shërbim joniversal postar			
2,1	Postë brenda vendit	2.819.601	1.486.594	-47,3%
2,2	Postë ndërkombëtare	6.616	7.389	11,7%
2,3	Totali 2.1+2.2	2.826.217	1.493.983	-47,1%
3	Shërbim ekspres			
3,1	Ekspres brenda vendit	699.731	647.849	-7,4%
3,2	Ekspres ndërkombëtar	18.842	68.948	265,9%
3,3	Totali 3.1+3.2	718.573	716.797	-0,2%
Ofruesit e shërbimeve postare				
4	Shërbim JoUniversal Postar			
4,1	Postë brenda vendit	490.900	698.388	42,3%
4,2	Postë ndërkombëtare	35.486	39.769	12,1%
4,3	Totali 4.1+4.2	526.386	738.157	40,2%
5	Shërbim ekspres			
5,1	Ekspres brenda vendit	1.408.298	2.010.034	42,7%
5,2	Ekspres ndërkombëtar	222.725	246.931	10,9%
5,3	Totali 5.1+5.2	1.631.023	2.256.965	38,4%
6	Totali 1.3+2.3.3.3+4.3+5.3	25.413.916	29.676.180	16,8%

Nga të dhënat e Tabelës 1.1 rezultojnë disa tregues të rëndësishëm të tregut postar:

Sipas të dhënave të dërguara nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare për vitin 2019, disa nga treguesit kryesorë të shërbimeve postare, për ofrimin e shërbimeve postare në raport me popullsinë dhe sipërfaqen e Republikës së Shqipërisë rezultojnë të jenë:

- Objekte postare gjithsej **29,676,180** në raport me popullsinë (banorë rezident) 2,862,427¹janë: **10.36 objekte / banorë.**
- Numri i zyrave postare të hapura për publikun në raport me popullsinë 2,862,427 janë: **2,773 banorë / zyrë.**

¹ Popullsia 1 janar 2019, INSTAT


- Numri i zyrave postare të hapura për publikun në raport me sipërfaqen 28,748 Km² janë: **27.85 Km² / zyrë.**

2. Treguesit dhe evidenca e realizimit të Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare

Posta Shqiptare ruan deri në vitin 2020 të drejtën si ofrues i vetëm i shërbimit universal postar. Volumin kryesor në shërbimin universal postar brenda vendit e zënë Objektet e thjeshta me 16,693,931 copë ose 85% të ndjekura nga Objektet e regjistruara me 2,923,893 copë ose 15%.


Në grafikët 2.1 dhe 2.2 të paraqitur më poshtë, jepen të dhënat lidhur me numrin e objekteve të shërbimit universal postar brenda vendit të pranuar nga Ofruesi i Shërbimit Universal gjatë vitit 2019, si dhe të dhënat krahasimore të këtyre shërbimeve në raport me vitet paraardhëse.

Grafiku 2.1




Nga të dhënat e grafikut 2.2 vihet re se në vitin 2019 ka një rritje prej 7% të numrit të objekteve postare brenda vendit krahasuar me 2018.

Grafiku2.2




Nga të dhënat e grafikut 2.3 vihet re se volumin kryesor në shërbimin universal postar ndërkombëtar për Objektet Postare të pranuar në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit e zënë Objektet e regjistruara me 412,659 copë ose 60% të ndjekura nga Objektet e thjeshta me 275,298 copë ose 40%, ndërsa në Objekte hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri vendin kryesor e zënë Objektet e thjeshta me 3,051,700 copë ose 73% të ndjekura nga Objektet e regjistruara me 1,112,797 copë ose 27%.

Grafiku 2.3




Nga të dhënat e grafikut 2.4 vihet re se gjate vitit 2019 Posta Shqiptare ka realizuar gjithsej 4,852,454 objekte postare të pranuar në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit dhe Objekte hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri.

Grafiku 2.4




3. Treguesit e shërbimit jo-universal postar

Grafiku 3.1




Nga të dhënat e grafikut 3.1 vihet re se volumin kryesor në shërbimin jouniversal postar brenda vendit për Postën Shqiptare e zënë Objektet e regjistruara me 1,457,668 copë ose 98% të ndjekura nga Objektet e thjeshta me 28,926 copë ose 2%.

Grafiku 3.2




Nga të dhënat e grafikut 3.2 vihet re se volumin kryesor në shërbimin jouniversal postar brenda vendit për Operatorët e tjerë postar e zënë Objektet e thjeshta me 475,680 copë ose 68% të ndjekura nga Jo dokumenta Pako/Koli me 177,863 copë ose 26%.

Grafiku 3.3




Nga grafiku 3.3 vihet re se Posta shqiptare mbulon 68% të shërbimit jo-universal postar brenda vendit me 1,486,594 objekte, ndërsa ofruesit e tjerë të shërbimeve postare mbulojnë 32% me 698,388 objekte.

Grafiku 3.4



Nga të dhënat e grafikut 3.4 vihet re se volumin kryesor në shërbimin jo-universal postar ndërkombëtar për Postën Shqiptare për Objektet postare të pranuar në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit e zënë Objektet e regjistruara me 6,573 copë ose 96% të ndjekura nga Objektet e thjeshta me 241 copë ose 4% , ndërsa për Objekte hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri volumin kryesor e zënë Objekte të regjistruara/shërbime të veçanta me 479 copë ose 83%.


Grafiku 3.5



Nga të dhënat e grafikut 3.5 vihet re se volumin kryesor në shërbimin jo-universal postar ndërkombëtar për Operatorët e tjerë postar për Objektet postare të pranuar në Shqipëri dhe të


dërguara jashtë vendit e zënë Objektet e korrespondencës me 7,230 copë ose 54% të ndjekura nga Jo dokumente Pako/Koli me 6,084 copë ose 46%, ndërsa për Objekte hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri vendin kryesor e zënë Jo Dokumente Pako/Koli me 15,480 copë ose 59% të ndjekura nga Objektet e korrespondencës me 10,975 copë ose 41%.

Grafiku 3.6



Nga grafiku 3.6 vihet re se Posta shqiptare mbulon 16% të shërbimit jouniversal postar ndërkombëtar me 7,389 objekte, ndërsa ofruesit e tjerë të shërbimeve postare mbulojnë 84% me 39,769 objekte.

Grafiku 3.7




Nga grafiku 3.7 vihet re se Posta shqiptare mbulon 67% të shërbimit jo-universal postar (kombëtar dhe ndërkombëtar) me 1,493,983 objekte, ndërsa ofruesit e tjerë të shërbimeve postare mbulojnë 33% me 738,157 objekte.


4. Treguesit e shërbimit Ekspres

Nga të dhënat e grafikut 4.1 vihet re se 99.5% e shërbimit ekspres brenda vendit mbulohet nga Dokumente ndërsa në shërbimin ekspres ndërkombëtar 87% e shërbimit mbulohet nga objekte postare të pranuar në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit dhe 13% nga objekte hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri.

Grafiku 4.1




Grafiku 4.2



Nga të dhënat e grafikut 4.2 vihet re se për Postën Shqiptare 90% e shërbimit ekspres mbulohet nga shërbimi ekspres brenda vendit dhe vetëm 10 % nga shërbimi ekspres ndërkombëtar.

Grafiku 4.3



Nga të dhënat e grafikut 4.3 vihet re se për Postën Shqiptare gjatë vitit 2019 shërbimi ekspres në total (brenda vendit dhe ndërkombëtar) ka mbetur në të njëjtat vlera si vitin e shkuar.


Në vijim jepen në formë tabelore dhe grafike të dhënat statistikore për Ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare për shërbimet ekspres, me qëllim vlerësimin dhe krahasimin e tyre.

Tabela 4.4


	Totali	Albanian Delivery Express	Albanian Cargo Service	Albanian Courier	DHL	SKY NET LOGISYIC	TNT	FEDEX	United Transport	YAPS	Albanian Parcel Distribution	SPEED COURIERS ALBANIA	INTEX COURIER sh.p.k	TURBOO ALBANIA sh.p.k
Ekspres brenda vendit	2.010.034	1.166.500	0	533.240	26.003	0	114.710	0	275	154.760	3.013	1	2.960	8.572
Ekspres ndërkombetar	246.931	4.126	18	36.321	141.971	641	0	35.163	28.691	0	0	0	0	0

Referuar tabelës 4.4 rezultojn se për ofruesit e shërbimeve postare ekspres brenda vëndit treguesit më të mirë për objektet e pranuar i ka Albanian Delivery Express me 1,166,500 objekte. Për sa i përket objekteve ekspres ndërkombëtare treguesit më të mirë i ka DHL me 141,971 objekte.

Grafiku 4.5




Grafiku 4.6




Në grafikët e mësipërm është paraqitur mbulimi i tregut postar nga ofruesit e tjerë të shërbimeve postare të ndara në ekspres brenda vendit dhe ekspres ndërkombëtar.

Grafiku 4.7




Nga të dhënat e grafikut 4.7 rezulton se gjatë vitit 2019 operatorët e tjerë të shërbimeve postare kanë realizuar 2,256,965 objekte postare që i përkasin shërbimit ekspres ose 75% dhe 738,157objekte postare që i përkasin shërbimit jo-universal ose 25%.

Grafiku 4.8




Grafiku 4.9




Nga të dhënat e grafikëve 4.8 dhe 4.9, nga duket krahasimi i shërbimit ekspres në total të Postës Shqiptare dhe Ofruesve të tjerë të shërbimeve postare rezulton se Ofruesit e tjerë të shërbimeve postare mbulojnë 76% të tregut ekspres me 2,256,965 objekte postare dhe Posta Shqiptare 24% me 716,797 objekte postare.,

Grafiku 4.10



Nga të dhënat e grafikut 4.10 vihet re se gjatë vitit 2019 Posta Shqiptare ka realizuar 26,681,058 objekte postare në total ose 90% kundrejt 2.995,122 objekte postare në total për gjithë ofruesit e tjerë të shërbimeve postare në total ose 10%.

Grafiku 4.11



Nga të dhënat e grafikut 4.11 vihet re se gjatë vitit 2019 ka pasur një rritje prej 4,262,264 objekte postare ose 17% krahasuar me vitin 2018.

5. Treguesit teknik të rrjetit postar

Posta Shqiptare e cila ofron shërbim në të gjithë vendin në **559** zyra të hapura për publikun ka treguesit më të mirë të rrjetit, e ndjekur nga Albanian Courier, Albanian Cargo Service, United Transport, Albanian Delivery Express, TNT etj.

Posta Shqiptare ka vënë në dispozicion të publikut për ofrimin e shërbimit universal 700 sportele nga të cilët 521 sportele janë të automatizuar/kompjuterizuar.


Për pranimin e objekteve postare ka vënë në dispozicion të përdoruesve 579 kuti postare dhe për dorëzimin e objekteve postare 667 kuti postare, gjithsej 1,246 kuti postare.

Në përgjithësi prezenca e zyrave postare të ofruesve të tjerë, përveç Postës Shqiptare, është në qytetet kryesore të vendit.


Për sa i përket infrastrukturës së mjeteve postare, Posta Shqiptare ka në përdorim 416 mjete transporti, Albania Courier 45, Albanian Delivery Express 69, FEDEX 88, TNT 52, të pasuar nga Ofruesit e tjerë.

Në mjetet e transportit përfshihen kamiona, furgona, vetura, motoçikleta dhe biçikleta.

Grafiku 5.1



Grafiku 5.2



6. Cilësia dhe standardet e shërbimit postar

Tabela 6.1

SHU - VITI 2019	Postë brenda vendit							Postë ndërkombëtare				
	Brenda për brenda qytetit		Ndërmjet qyteteve		Në fshatra			Vendet e BE (Europë)			Vendet e tjera (UPU)	
	D+1	D+2	D+1	D+2	D+2	D+3	D+4	D+3	D+5	D>5	D+5	D>5
	96,50%	3,5%	95,3%	4,7%	80,9%	19,1%	0,0%					


Tabela 6.2

	Postë brenda vendit			Postë ndërkombëtare		
	D+1	D+2	D>2	D+1	D+2	D>2
Albanian Delivery Express	90	7	3	85	10	5
Albanian Cargo Service	0	0	0	90	10	0
Albanian Courier	95	5	0	85	15	0
DHL	98,1	1,9	0	94,9	4,1	1
SKY NET LOGISYIC	0	0	0	0	0	100
TNT	47	12	41	40	28	32
FEDEX	90	10	0	54	46	0
United Transport	99	1	0	37	63	0
YAPS	75	0	25	0	0	0
Albanian Parcel Distribution	100	0	0	0		
SPEED COURIERS ALBANIA						
INTEX COURIER sh.p.k	95	5	0	0	0	0
TURBOO ALBANIA sh.p.k						


7. Të punësuarit

Në funksion të volumit të punës Posta Shqiptare ka 2,421 të punësuar, Fedex 96, Albania Courier 70, Albanian delivery 72, të ndjekur nga subjektet e tjerë sipas shifrave që paraqiten në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 7.1




Grafiku 7.2



Nga të dhënat e grafikut 7.2 duket qartë se Posta Shqiptare mbulon 83% të tregut postar të të punësuarve në total kundrejt 17% të ofruesve të tjerë së bashku.


Grafiku 7.3




8. Ankesat

Sipas të dhënave të dërguara, gjatë vitit 2019 pranë Posta Shqiptare janë depozituar 1,131 reklamacione nga të cilat janë zgjidhur 1131, pranë DHL janë depozituar 42 reklamacione të cilat janë zgjidhur plotësisht , Rad Mail kanë regjistruar 2 nga të cilat kanë zgjidhur 2 reklamacione.

Grafiku 8.1



Grafiku 8.2



Nga krahasimi i ankesave (reklamacioneve) të pranuar, gjatë vitit 2019 vërehet një rënie me rreth 15% të ankesave për ofruesin e shërbimit universal dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare në krahasim me vitin 2018, gjithashtu nga krahasimi i ankesave (reklamacioneve) të zgjidhura gjatë vitit 2018 vërehet një rritje me rreth 19% të ankesave të zgjidhura nga ofruesi i shërbimit universal dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare në krahasim me vitin 2018.

9. Rezultatet financiare²

Bazuar në të dhënat e raportuara për vitin 2019 nga ofruesi i shërbimit universal postar dhe ofruesit e shërbimeve postare, të ardhurat financiare në tregun postar rezultojnë të jenë **2.357.938.217** Lekë. Pjesën më të madhe në këtë treg e zotëron Posta Shqiptare me një total të ardhurash 1,532,643,060 Lekë dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare kanë realizuar të ardhura në total 825,295,157 Lekë. Në grafikun e mëposhtëm jepet shpërndarja e pjesëve të tregut postar bazuar në të ardhurat për vitin 2019. Posta Shqiptare zotëron 65% të tregut, e pasuar nga DHL Albania me 24% të tregut dhe me pas ofruesit e tjerë. Të ardhurat nga shërbimet postare për vitin 2019 janë rritur me 10% në krahasim me vitin 2018.

Tabela 9.1 Të ardhurat në sektorin postar Viti 2019

Subjekti	Totali i të ardhurave nga shërbimet postare
Posta Shqiptare	1.532.643.060
Ofrues të shërbimeve postare	825.295.157
Totali	2.357.938.217

² Te dhena te raportuara nga ofruesit e shërbimeve postare deri ne Prill 2020

Grafik 9.1 Pjesë tregu në të ardhura




Tabela 9.2 Posta Shqiptare - Të ardhura në vitin 2019 sipas shërbimeve

Të ardhurat nga shërbimet postare	
Shërbimi postar universal	1.304.029.955
Shërbimi postar jo universal	12.451.045
Shërbimi postar ekspres	216.162.060
Të ardhurat nga shërbimet postare	1.532.643.060

Grafik 9.2 Posta Shqiptare - Pjesë tregu të ardhura sipas shërbimeve




Tabela 9.3 Të ardhura dhe investime 2012 - 2019

Viti	Të ardhura	Investime
Viti 2012	1.769.967.446	135.656.095
Viti 2013	1.671.824.969	46.295.355
Viti 2014	1.879.101.654	141.184.903
Viti 2015	2.086.312.500	135.695.945
Viti 2016	2.079.437.005	227.660.486
Viti 2017	2.323.211.780	251.457.280
Viti 2018	2.138.499.881	193.341.957
Viti 2019	2.357.938.217	19.164.469

Grafik 9.3 Ecuria e të ardhurave dhe investimeve

